




REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
01 Nr. 400/01-17943
15/05/2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Duke u bazuar në nenin 4, paragrafët 9 dhe 10 të Kontratës bazë për Qiradhënie, me numër protokoli 10121, të datës 30.12.2013, për "Parkun e Biznesit Drenas", nxirret kjo:

ANEKS KONTRATË

E lidhur më datë 16.05.2025 ndërmjet:

QIRADHËNËSI: Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), e përfaqësuar nga z. Zef Dedaj, U.d. i Drejtorit të Përgjithshëm, dhe Komuna e Glogocit, e përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës.

QIRAMARRËSI: WINTECH Windows Technology SH.P.K., me numër unik identifikues 810833021, e përfaqësuar nga z. Albion Asllanaj, Skenderaj.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj aneks-kontrate është të ndryshohet pronësia nga biznesi METROPOL GROUP SH.P.K. në biznesin WINTECH Windows Technology SH.P.K., në kuadër të Kontratës Bazë për Qiradhënie, me numër protokoli 10121, të datës 30.12.2013, për "Parkun e Biznesit Drenas".

Neni 2

1. Bazuar në nenin 4, paragrafi 10 të Kontratës Bazë për Qiradhënie, me numër protokoli 10121, të datës 30.12.2013, për "Parkun e Biznesit Drenas", Qiramarrësi METROPOL GROUP SH.P.K., me numër regjistrimi të biznesit 71001962, me adresë në Veternik, i përfaqësuar nga z. Armend Susuri, i lindur më 05.08.1971 në Prizren, me numër të letërnjoftimit 1170780830, ka paraqitur kërkesën nr. 4238/12, datë 14.07.2023, për pëlqim për shitjen e aksioneve/aseteve të METROPOL GROUP SH.P.K. Në lidhje me këtë kërkesë, me datë 02.05.2025, i është dhënë pëlqimi nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë për shitjen e aksioneve, dhe me datën 04.05.2025, i është dhënë pëlqim dhe miratimin nga Komuna e Drenasit për shitjen e aksioneve të kompanisë METROPOL GROUP SH.P.K.

[Handwritten signature]

2. Qiramarrësi WINTECH Windows Technology SH.P.K. është i detyruar t'i përmbahet të gjitha kushteve dhe obligimeve të kontratës së trashëguar nga qiramarrësi paraprak, me kusht që:

2.1. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën ekzistuese të qirasë të mbeten të pandryshuara.

2.2.. Aktiviteti i kompanisë në Parkun e Biznesit në Drenas të vazhdojë sipas kushteve të kontratës ekzistuese.

3. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga ana e Qiramarrësit WINTECH Windows Technology SH.P.K., sipas Kontratës Bazë për Qiradhënie, me numër protokolli 10121, të datës 30.12.2013, për "Parkun e Biznesit Drenas", Qiradhënësi rezervon të drejtën të ndërmarrë masat përkatëse në përputhje me dispozitat kontraktuale dhe ligjore në fuqi.

Neni 3

Palët kontraktuese obligohen të përmbushin të gjitha obligimet e mbetura sipas Kontratës Bazë për Qiradhënie, me numër protokolli 10121, të datës 30.12.2013, për "Parkun e Biznesit Drenas".

Neni 4

1. Aneks kontrata është pjesë përbërëse e Kontratës bazë me numër të protokollit 10121, të datës 30.12.2013 për Qiradhënie për "Parkun e Biznesit në Drenas".

2. Pjesë e kësaj aneks kontrate është edhe Certifikata e Regjistrimit të Biznesit dhe Informata mbi Biznesin WINTECH Windows Technology SH.P.K.

Neni 5


1. Aneks kontrata hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga të dy palët nënshkruese.

2. Kjo aneks kontratë është përpiluar në katër (4) kopje identike, prej të cilave secila palë mban nga një (1) kopje.


PALËT NËNSHKRUESE:

QIRADHËNËSI


Agjencia për Investime dhe Përkrahjen WINTECH Windows Technology SH.P.K. Komuna e Gillogocit e Ndërmarrjeve në Kosovë


Zef Dedaj
U.d. Drejtor i Përgjithshëm

QIRAMARRËSI


Albion Asllanaj
Pronar


QIRADHËNËSI


Ramiz Lladrovci
Kryetar
